



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 459, date 23.9.1999

PER
KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETEROR PER KULTET

Ne mbeshtetje te neneve 10 dhe 100 te Kushtetutes, me propozimin e zevendes kryeministrit dhe minister i Koordinimit Qeveritar, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komitetit shteteror per kultet, per realizimin e marredhenieve ndermjet shtetit dhe komuniteteve fetare e organizatave shoqerore te çdo lloji, qe kane objekt veprimtarie dhe ndjekin qellime fetare, si organ shteteror ne varesi te Keshillit te Ministrave.

2. Komiteti shteteror per kultet pergjigjet perpara Keshillit te Ministrave, per veprimtarine e tij. Ky komitet ka pergjegjesite si vijon:

- Bashkerendon marredheniet me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare.
- Negocion per pergatitjen e marreveshjeve ndermjet perfaqesuesve te bashkesive fetare dhe Keshillit te Ministrave.
- Eshte asnjanes ne çeshtjet e besimit, njeh barazine e bashkesive fetare dhe respekton pavaresine e tyre. Gjithashtu punon per garantimin e lirise se besimit e per zhvillimin, bashkepunimin, mirekuptimin dhe tolerancen nderfetare ne Shqiperi.
- Ndihton dhe mbeshtet veprimtarite e mirefillta fetare, bazuar ne Kushtetuten dhe ne ligjet perkatese, qe rregullojne problemet konkrete.
- Bashkepunon me bashkesite fetare per pergatitjen e projektligjeve dhe te akteve nenligjore, qe kane te bejne me kultet fetare.
- I paraqet Ministrise se Arsimit dhe Shkences mendimin e tij lidhur me planin mesimor, programet lendore dhe tekstet e pjeses jolaike, per kerkesat e paraqitura per hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotesuese jopublike ku zhvillohen lende fetare, dhe ne

bashkepunim me ate institucion, ne varesi te ndarjes administrative territoriale, te nevojave e interesave te perbashketa ekonomike dhe te tradites historike e fetare, percakton dhe numrin e institucioneve arsimore jopublike dhe institucioneve plotesuese jopublike ku zhvillohen lende fetare.

- Ne bashkepunim me Institutin e Monumenteve te Kultures dhe me komunitetet fetare interesohet per ruajtjen e vlerave te objekteve te kultit.
- Vendos dhe zhvillon lidhje me institucionet homologe, te vendeve te tjera e te diaspores.
- I paraqet Ministrise se Financave mendimin e tij, lidhur me hyrjen ne territorin e Republikes se Shqiperise te mallrave me karakter fetar per komunitetet fetare, dhe per perjashtimin e tyre nga taksa doganore ne perputhje me ligjet ne fuqi.

3. Komiteti shteteror per kultet perbehet nga kryetari dhe 4 anetare.

Perberja e ketij komiteti, struktura organizative dhe rregullorja e funksionimit te tij miratohen nga Kryeministri.

4. Paga e kryetarit te Komitetit shteteror per kultet te jete sipas nivelit A12, te lidhjes I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", te vendimit te Keshillit te Ministrave nr.393, date 3.9.1992 "Per pagat e punonjesve ne institucionet buxhetore", ndersa punonjesit e tjere te trajtohen ne nivelin e punonjesve te ministrive.

5. Efektet financiare te krijimit dhe funksionimit te Komitetit shteteror per kultet te perballohen nga fondet buxhetore te miratuara per Sekretariatin Shteteror te Fese per vitin 1999.

6. Ngarkohet Komiteti shteteror per kultet, per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

PANDELI MAJKO



ZEVENDESKRYEMINISTRI DHE
MINISTER I KOORDINIMIT QEVERITAR

ILIR METAJ

Nr.Prot. 1941/5
Date 4.10.1999

KOMITETIT SHTETEROR PER KULTET
MINISTRISE SE DREJTESISE
MINISTRISE SE FINANCAVE
MINISTRISE SE ARSIMIT DHE SHKENCES
MINISTRISE SE PUNES DHE ÇESHTJEVE SOCIALE
KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TE SHQIPERISE
KONFERENCES IPESHKVNORE SHQIPTARE
KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR
KRYEGJYSHATES BOTERORE BEKTASHIANE
INSTITUTIT TE MONUMENTEVE TE KULTURES

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

QIRJAKO QIRKO

